



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI

DEKRET
PER KTHIMIN E LIGJIT NR 8450, DATE 28.1.1999
“ PER PERPUNIMIN, TRANSPORTIMIN DHE TREGTIMIN E
NAFTES, GAZIT DHE TE NENPRODUKTEVE TE TYRE”

Në mbështetje të neneve 85 dhe 93 të Kushtetutës

DEKRETOJ

Kthimin e ligjit nr 8450, datë 28.1.1999 “ Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre” për rishqyrtim edhe njëherë në Kuvend.

Tiranë, më 9. 2.1999
Nr i dekretit 2311

PRESIDENTI I REPUBLIKES
REXHEP MEIDANI

Te futet ne meqenese meqenese
[Signature]

A promise returned
and 15/2/99
[Signature]

44

Ligjin nr 8450, datë 28.1.1999 “ Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre” vendosa të mos e shpall, por ta kthej për shqyrtim edhe njëherë në Kuvend me synim përmirësimin e tij

Nga studimi i këtij ligji rezulton se formulimi i nenit 23 , “Inspektoriati Shtetëror i Karburanteve”, nuk duket i përshtatshëm përse i përket vartësisë së këtij inspektoriati nga Ministria e Financave. Kjo sepse fusha e veprimtarisë së tij do të jetë shumë më e gjërë se sa ajo fiskale. Detyrat që do të ndjekë ai në përputhje me nenin 23, pika 2 të ligjit, janë të karakterit teknik dhe teknologjik e për këtë arsye mundësitë për gritjen dhe funksionimin e këtij Inspektoriati do të jenë më të mëdha nëse ai do të jetë në varësi të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, duke plotësuar në këtë mënyrë edhe aktivitetet që rregullohen nga ligji “ Për hidrokarburet”. Në këto kushte mendoj se ligji do të jetë më organik dhe plotësisht i aplikueshëm në praktikë.

Nga konsultat e zhvilluara kam konstatuar se të të njëjtit mendim, sa më sipër, janë edhe Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë dhe Privatizimit, si dhe ajo e Drejtësisë.

PRESIDENTI I REPUBLIKES